



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:101203

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474185

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Prizrenit me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson Avokatura Publike e Komunës, kundër të paditurës NTP “SEDTOURS”, me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson me autorizim E.R. avokat nga Prizreni, me objekt kontesti pagesë e borxhit, vlera e kontestit 7,781.68 €, në seancën përgatitore të datës 12.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia me numër KE.nr 958/22 (C.nr 1050/22 - 2020:101204) e datës 01.10.2002 e paditësit Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës NTP “SEDTOURS”, me objekt kontesti pagesë e borxhit, vlera e kontestit 7,781.68 €.
- II. DETYROHET paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të ia paguaj palës së paditur shumën prej 835.00 € (tetëqind e tridhjetë e pesë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Paditësi Komuna e Prizrenit, me datën 01.10.2002, pranë Gjykatës Komunale në Prizren, ka paraqitur padi për pagesë të borxhit, në vlerën prej 7,781.68 €, ndaj të paditurës NTP “SEDTOURS”.

Gjykata Komerciale e Kosovës, pas kthimit të kësaj çështje juridike në rigjykim, ka caktuar seancën përgatitore për datën 12.03.2024, në të cilën seancë, nuk ka prezantuar

përfaqësuesi me autorizim i palës paditëse nga Avokatura Komunale Publike, ndërsa ka prezantuar i autorizuari i palës së paditur avokati E.R..

Nga fletëkthesat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se palës paditëse Komunes së Prizrenit, thirrja për këtë seancë i është dorëzuar në mënyrë të rregullt me datën 28.02.2024, ndërsa të njëjtit, përmes komunikimit elektronik të datës 12.03.2024, në ora 10:35, e kanë njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantojnë në seancën përgatitore meqenëse të njëjtit janë të angazhuar tej mase me përfaqësime të tjera dhe lëndë për procedim të natyrës urgjente, duke i propozuar gjykatës që seanca e sotme të shtyhet për një datë tjetër.

Përfaqësuesi i palës së paditur, avokati E.R., në seancën përgatitore të datës 12.03.2024, i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr, duke i kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes të parashtrësës përmes komunikimit elektronik të datës 12.03.2024, të paraqitur nga përfaqësuesja e paditësit V.Xh., gjeti se kërkesa për shtyrjen e seancës nuk është e bazuar në asnjërin nga shkaqet e përcaktuara me nenin 438 të LPK-së.

Gjykata vlerëson se kërkesa për shtyrjen e seancës është e pabazuar për faktin se kërkesës nuk i është bashkëngjitur asnjë dëshmi përmes të cilës do të mund të vërtetohet se përfaqësuesit e palës paditëse kanë qenë të angazhuar me përfaqësime në seanca tjera. Për më tepër paditësi njoftimin për mos prezencë në seancën e datës 12.03.2024 të caktuar në ora 13:30, e ka paraqitur vetëm disa orë para mbajtjes së kësaj seance.

Sipas nenit 402 par.2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Letërthirrja për në seancë përgatitore, si rregull, u dërgohet palëve së paku shtatë (7) ditë para ditës në të cilën mbahet ajo.”* Në këtë drejtim gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit se janë të angazhuar me përfaqësime dhe lëndë të natyrës urgjente, rezulton në tërësi si i pabazuar, pasi që në cilëndo rrethanë, paditësi për çdo seancë të caktuar njoftohet si rregull së paku shtatë ditë para mbajtjes së seancës dhe rrjedhimisht duke marr për bazë faktin që paditësi lidhur me mbajtjen e seancës përgatitore është njoftuar me datën 28.02.2024, rezulton se i njëjti ka pasur mundësi që menjëherë ta njoftoj gjykatën për pamundësinë eventuale të pjesëmarrjes në seancë dhe për më tepër ka qenë i obliguar që gjykatës të ia dorëzoj edhe provat përmes të cilave do të vërtetonte shkaqet për mos pjesëmarrjen në seancë.

Andaj nisur nga fakti se përfaqësuesi i palës paditëse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë, i njëjti nuk ka marr pjesë në seancë, si dhe shkaqet në të cilat është mbështetur kërkesa e tij, nuk paraqesin bazë për shtyrjen e seancës, si dhe të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për të arsyetuar mungesën e tij, gjykata duke u bazuar në nenin 409 paragrafin 1 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit Komuna e Prizrenit, kundër të paditurit NTP “SEDTOURS”.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga i padituri sipas tarifës së OAK dhe atë për pjesëmarrje në pesë (5) seanca gjyqësore, në shumën prej 675.00 € (135 € x 5) si dhe për përpilimin e ankesës sipas lëndës C.nr 50/16 të datës 27.03.2017 shumën prej 160.00 €, në shumë të përgjithshme prej 835.00 €.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 409 par.1 dhe nenin 452 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.958/22, datë 12.03.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.